

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Operatori Ekonomik: Commando Sh.p.k me adresë në Prizren Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	02.12.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **01.12.2021**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Commando Sh.p.k** me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE TË OBJEKTEVE TË KOMUNËS – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-21-8508-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-024-2-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Commando Sh.p.k** me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE TË OBJEKTEVE TË KOMUNËS – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-21-8508-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-024-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **01.11.2021**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim për Kontratë të Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE TË OBJEKTEVE TË KOMUNËS – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-21-8508-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-024-2-1-1**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Commando Sh.p.k** me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE TË OBJEKTEVE TË KOMUNËS – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-21-8508-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-024-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **01.11.2021**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **01.12.2021**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR:

Autoriteti Kontraktues nuk ka mundur të planifikoj si duhet këtë aktivitet të prokurimit pasi që me vlerën e parashikuar të kësaj kontrate nuk mund të ekzekutohet me kërkesat që i ka kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë lidhur me pagat e punëtorëve, me c'rast ka bërë edhe shkeljen e detyrimeve kontraktuale dhe të drejtave të punëtorëve që do të angazhohen në të ardhmen për këtë kontratë.

Neni 7 (LPP)

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.
3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoriteti kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasi të artikujve të tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

Pra Autoriteti Kontraktues me rastin e hartimit të specifikacionit teknik nuk ka parashikuar vlerën e kontratës si duhet sepse nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagat e punëtorëve. Andaj me këtë buxhet sic e potencuam nuk mund të realizohet kontrata si duhet, ose OE që do të arrij ta nënshkruaj kontratën nuk do të mund ta realizon pa bërë ndonjë shkelje apo shmangie.

Pagat e punëtorëve për Lot 1 dhe Lot 2 sipas kërkesës suaj me atë numër të punëtorëve nuk mund të mbulohen me këtë vlerë, andaj rritja e vlerës së parashikuar të kontratës është e domosdoshme për realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Kërkojmë nga AK që ta plotësojmë kërkesën tonë për rishqyrtim sipas Rregullave për parashtrimin e ankesave për shkak të afatit kohor të ngusht kohorë dhe jemi me vonesë sepse sot e kemi kuptuar që është hapur ky aktivitet i prokurimit.

Kërkojmë nga ana e AK-së që të APROVOJ kërkesën tonë për rishqyrtim dhe lënda të kthehet në Korrigjim të dosjes së tenderit dhe rritjen e vlerës sëparashikuar.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, për këtë aktivitet të prokurimit është bazuar në:

Neni 17, parag. 17.1 e LPP-së ku thotë:

Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për shërbime është e barabartë me pagesën e përgjithshme dhe shumat e kompensueshme që do të paguhet nga autoriteti kontraktues sipas kontratës, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, duke pasur parasysh dispozitat e këtij neni. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar për shërbime, autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për shërbimet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, detyrimet dhe tarifat e tjera.

Neni 5.13 i RRUOPP-së thotë:

Për të kryer një planifikim të mirë të prokurimit zyrtarit të prokurimit do ti nevojitet bashkëpunimi i ngushtë me departamentin e buxhetit dhe departamentet tjera. Zyrtari i prokurimit do të takohet me personat përgjegjës për buxhet dhe departamentet që bëjnë kërkesat (përdoruesit) dhe të diskutojë kërkesat e tyre për prokurim dhe buxhetin në disponueshmëri për vitin e ardhshëm dhe do të vendosë cilët artikuj të përfshihen në planifikimin paraprak dhe final të prokurimit.

Andaj ashtu siç e kemi cekur me lartë me shumën e menduar prej:

Lot I – 120,000.00 €

Lot II – 10,000.00 €

Lot III – 120,000.00 €

Gjithsej Totali: 250,000.00 €

Mund të realizohen këto shërbime për periudhën prej: 24 muaj, duke u bazuar ne Kontratat qe janë realizuar me ketë vlerë, që nga viti 2014, kur Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit ka iniciuar këtë aktivitet te prokurimit.

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit